



Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindor - OFAP

STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT

PËR

ORGANIZATËN OFAP (2019-2021)

Prishtinë, 2019

PËRMBAJTJA:

Falënderim.....	3
Parathënie.....	4
Hyrje.....	5
Metodologjia.....	6
Trajtimi në aspektin ligjor.....	7
Profili i Organizatës OFAP - Vizioni, Misioni, Qëllimi.....	8
Analizë rreth Organizatës OFAP.....	9
Monitorimi dhe raportimi.....	10
Objektivat e Përgjithshme.....	11
Plani i Veprimit.....	12

Falënderim:

Organizata OFAP e sheh rëndësinë e Strategjisë dhe Planit të Veprimit si udhëzues në zhvillimin dhe rritjen e saj si një organizatë kombëtare në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me theks të veçantë, fëmijët pa kujdes prindëror, të braktisur, keqtrajtuar dhe të lënë pasdore. Me anë të këtij dokumenti strategjik, Organizata synon të vendos një kornizë gjithëpërfshirëse të politikave të Organizatës OFAP si dhe të shërbejë në masën më të madhe të mundshme në unifikimin e projekteve që i referohen të drejtave të fëmijëve. Ky dokument strategjik nuk do të ketë kuptim nëse nuk do të reflektojë në frymën gjithëpërfshirëse, me qëllim ndërmarrjen e nismave për të përmirësuar gjendjen e fëmijëve në përgjithësi e në veçanti fëmijët e braktisur dhe pa kujdes prindëror. Dokumenti në fjalë, u hartua nën mbikqyrjen e Ekspertit Besnik Murati si dhe Grupit punues të stafit të Organizatës OFAP, të cilët dhanë një kontribut të madh për gjatë gjithë procesit. Organizata OFAP është mirënjohës dhe falënderues për sinqeritetin dhe kontributin për realizimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit i cili do të jetë udhërrefyes si dhe barometër matës gjatë realizimit të projekteve.

Sinqerisht,

Ibadete Krasniqi

Drejtor Ekzekutiv i Organizatës OFAP

I. Parathënie:

Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror-OFAP, njëherit pasuese e misionit të Organizatës Amici Dei Bambini, është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden fëmijët në përgjithësi, më theks të veçantë, fëmijët e braktisur, keqtrajtuar dhe të lënë pasdore për sigurimin e një familje strehuese për fëmijët e braktisur. Bazuar në të dhënat zyrtare, numri i fëmijëve në strehim familjar tek të afërmit është 551, ndërsa numri i fëmijëve të braktisur të vendosur në strehimin familjar alternativ është 49, edhe pse, ky numër varion nga viti në vit. Sipas të gjitha studimeve vendore dhe ndërkombëtare si dhe duke u bazuar në Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe Konventat ndërlidhëse, tregojnë se në shoqëritë e zhvilluara, ofrimi i përkujdesjes shoqërore konsiderohet si një aspekt i rëndësishëm i rolit të shtetit dhe përfitimet nga përkujdesja janë pjesë e të drejtave të individit. Qasje kjo që ofron suksesin ose dështimin e përkujdesjes ndaj fëmijëve të braktisur, keqtrajtuar dhe të lënë pas dore e që për shumë arsye është vendimtare për mirëqenien e fëmijëve. Gjendja e tanishme e fëmijëve të braktisur nuk përmbush realizimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore në kushte të barabarta me të tjerët. Andaj, si rrjedhojë, të gjitha subjektet janë përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte e cila arrihet vetëm duke eliminuar çdo lloj pengese dhe barriere që krijon vështirësi në respektimin e parimit të mos-diskriminimit. Bazuar në këtë të vërtetë, i gjithë spektri ndërkombëtar ka ndërmarrë hapa të duhur drejt jetësimit të kësaj të drejte me konventa, standarde, ligje, rregullore etj., të cilat obligojnë shtetet për ti përvetësuar dhe plotësuar ato.

II. Hyrje:

Me qëllim të përgatitjes së këtij plani strategjik për vitin 2019-2021, Organizata OFAP në procesin e planifikimit ka përfshirë diskutime me anëtarët e stafit, ekspertët e jashtëm si dhe partnerët me të cilët organizata ka bashkëpunim të vazhdueshëm. Procesi i planifikimit strategjik është gjithëpërfshirës dhe brenda suazave të qëllimit dhe misionit të Organizatës OFAP. Prandaj, Organizata OFAP u ka mundësuar faktorëve në nivele të ndryshme të japin idetë e tyre dhe të kontribuojnë drejtpërdrejtë në organizatë.

Si hap i parë, në zhvillimin e Strategjis dhe Planit të Veprimit, Organizata OFAP ka angazhuar ekspertin për të udhëhequr procesin dhe për të përpiluar këtë Strategji. Përgjatë procesit të hartimit të dokumentit strategjik janë organizuar punëtori dhe takime individuale dhe grupe me Stafin si dhe akterët e tjerë relevant. Për të siguruar përfshirjen e të gjithë akterëve, është krijuar grupi punues për hartimin e kësaj strategjie. Pas analizës së shkurtër të gjendjes aktuale, janë përcaktuar objektivat e përgjithshme, objektivat strategjike, indikatorët dhe veprimet konkrete.

Procesi i Strategjis dhe Planit të Veprimit mund të përmblihet nëpërmjet aktiviteteve kryesore në vijim:

- Punëtoritë për realizimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
- Zhvillimi i draftit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
- Finalizimi dhe miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit pas shqyrtimit nga të gjithë akterët e përfshirë.
- Zhvillimi i draftit të Planit të Veprimit 2019-2021.
- Finalizimi dhe miratimi i Planit të Veprimit 2019-2021.
- Ndërsa, kostifikimi i Planit të Veprimit bëhet në vazhdimësi varësisht nga shuma e cila përcaktohet në implementimin si dhe realizimin e Projekteve.

Këta hapa zhvillimor kanë të bëjnë me çështjet kyçe gjatë analizës së brendshme dhe të jashtme të kryer gjatë procesit të planifikimit. Këto reflektojnë nevojën për të adresuar në mënyrë sa më të mirë të mundshme të gjitha fushat e nevojshme për përmirësimin e situatës.

Në këto fusha është përfshirë edhe përmirësimi i efektivitetit të organizatës, përmes ngritjes së kapaciteteve të brendshme. Ky plan strategjik do të shërbejë si udhëzues në zhvillimin dhe ngritjen e organizatës në të ardhmen.

III. Metodologjia:

Strategjia dhe Plani i Veprimit është hartuar duke u bazuar në një metodologji të kombinuar në mënyrë që të jetë sa më gjithëpërfshirëse, të adresojë prioritetet kyçe dhe të siguroj që intervenimet e përcaktuara do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike. Strategjia dhe Plani i Veprimit është hartuar në përputhje me Konventat Ndërkombëtare, Ligjet e aplikueshme në Kosovë, Statusin, Rregulloren si dhe Politikat e Organizatës OFAP. Procesi i hartimit të Strategjis dhe Planit të Veprimit është i ndarë në tri faza: faza e parë është karakterizuar me analizimin e situatës së përgjithshme, si dhe realizimin e një seri të takimeve konsultative, në të cilat kanë qenë të përfshirë punëtorët dhe akterët relevant; përgjatë fazës së dytë ekipi përgjegjës për hartimin e strategjisë ka analizuar dokumentet strategjike në fuqi, raportet e vlerësimit të ndryshme vendore e ndërkombëtare dedikuar fëmijëve; ndërsa, në fazën e tretë dokumenti i është nënshtruar procesit të konsultimit si dhe miratimit.

1. TRAJTIMI NË ASPEKTIN LIGJOR

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, paraqet themelet e secilit veprim në fushën e të drejtave të fëmijës. Parimet e saj janë të përqafuara në politika ndërkombëtare që prekin jetën e fëmijëve, por edhe në politikat vendore e lokale. Në vitin 2016, liderët botërorë në Kombet e Bashkuara zyrtarisht lansuan Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm. Kjo agjendë promovon 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm për ta transformuar botën deri më 2030¹. Për t'u arritur këto objektiva secili duhet të bëjë pjesën e vet të punës: qeveritë, sektori privat, shoqëria civile dhe të gjithë qytetarët. Kjo strategji është një kontribut në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, e përshtatur për kontekstin e Organizatës. Aq më parë, kur fëmijët janë në fokusin më të madh të këtyre objektivave, e në fokus ekskluziv të kësaj strategjie.

Në Kosovë, tashmë, disa vite e kemi projekt-ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në proces. Ky projekt-ligj e ndjek frymën e Konventës për të drejtat e fëmijës, si dhe tregon rolin e institucioneve në mbrojtjen e fëmijëve, krijimin e mekanizmave dhe masat e veçanta mbrojtëse. Duke besuar se ky ligj, posa të marrë miratimin final do të avancoj edhe më tutje realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre në përgjithësi në Kosovë. Mirëpo, derisa të miratohet Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve i cili do të jetë bazë ligjore në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të tyre, ne i referhohemi Ligjeve përcjellëse të cilat rregullojnë mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.

Ligji për Familjen i Kosovës Nr. 2004/32, afirmon përkujdesjen alternative për fëmijët pa kujdes prindëror - Strehimin familjar, por njëkohësisht e precizon përkohshmërinë e kësaj forme të mbrojtjes juridiko-sociale duke udhëzuar që të ndërmerren të gjitha masat e punës sociale për zgjidhjen sa më të shpejtë të statusit të fëmijës. Kurse mbështetja financiare e strehimit familjar mbështetet në Nenin 5, pika. 1: “Fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe ata me çrregullime mendore ose fizike të diagnostikuar, si dhe prindërit të cilët nuk janë të aftë të krijojnë kushtet e domosdoshme jetësore për vete dhe për fëmijët e tyre, janë nën përkrahjen e veçantë financiare dhe shoqërore”.

¹ www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17 përcakton dhe rregullon rolet dhe përgjegjësit e institucioneve të sistemit të mirëqenies sociale. Mbështet politikat e decentralizimit të shërbimeve sociale nga niveli qendror në nivel të qeverive lokale, i udhëhequr nga parimi i politikave moderne: shërbimet sa më afër qytetarit. Përcakton dhe precizon hierarkinë e renditjes dhe nënrenditjen e subordinimit të institucioneve përbrenda sistemit të mirëqenies sociale. Ligji Nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare në mënyrë taksative rregullon dhe precizon bazën ligjore të ndërtimit të sistemit rregullator të shërbimit social; Inspektimi, monitorimi, licencimi dhe standardizimi i shërbimeve sociale. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17 dhe Ligji Nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare përbëjnë bazën themelore për ndërtimin e sistemit rregullator të shërbimeve sociale dhe familjare. Po ashtu, njeh OJQ-të si entitete të pavarur dhe ligjëson bashkëpunimin me OJQ.

2. PROFILI I ORGANIZATËS OFAP - VIZIONI, MISIONI, QËLLIMI

Vizioni:

Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, është shoqatë humanitare kombëtare e themeluar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, me fokus me të madh tek fëmijët pa përkujdesje prindërore, të braktisur, keqtrajtuar dhe të lënë pasdore në Kosovë.

Misioni:

Misioni i Organizatës OFAP është që çdo fëmijë të braktisur dhe pa kujdes prindëror t'i ofrohet një familje për të jetuar, për t'u rritur, për t'u ndjerë pjesë dhe për të pasur dashurinë që u nevojitet. Në praktikën kosovare strehimi familjar aplikohet në dy forma: strehimi familjar brenda familjes (familjet strehuese janë nga rrethi familjar, të afërm të fëmijës) dhe strehimi familjar alternativ (familjet strehuese nuk kanë asnjë lidhje farefisnore, nuk janë të afërm të fëmijës). Organizata OFAP ofron mbështetje psikosociale në ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare konform Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, ligjeve si dhe udhëzimeve administrative të aplikuara në Kosovë.

Qëllimi:

Për të përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në këto lloje të aktiviteteve:

- Promovimi i të drejtave dhe mbrojtja e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit si dhe braktisjes së tyre.
- Organizimi i konferencave, tryezave, debateve, seminareve, trajnimeve të ndryshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.
- Ofrimin e përkrahjes psikosociale për të gjithë fëmijët në nevojë.
- Promovimi, zhvillimi dhe fuqizimi i strehimit familjar për fëmijët pa përkujdes prindëror, të braktisur, keqtrajtuar dhe të lënë pasdore.
- Realizimi i takimeve në mënyrë permanente me nivelin qendror dhe lokal për mbrojtje të fëmijëve në nevojë.
- Organizimin e aktiviteteve për mbledhjen e fondeve për të gjithë fëmijët në nevojë.
- Ofrimi i shërbimeve psikosociale për fuqizimin e familjeve në rrezik të braktisjes së fëmijëve.
- Bashkëpunimi me institucionet përkatëse në krijimin e mundësive për zhvillimin e politikave të barabarta në përputhje me ligjet në fuqi.

3. ANALIZË RRETH ORGANIZATËS OFAP

Analiza e brendshme e Organizatës OFAP ka vënë në pah informatat kyçe mbi funksionimin e organizatës si dhe elementet e brendshme të realizuara gjatë punëtorisë. Përparësitë e Organizatës OFAP janë të shumta, të cilat mund të analizohen në shumë aspekte dhe si të tilla, mund të sigurojnë një gamë të gjerë të shërbimeve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, me fokus të veçantë fëmijët pa kujdes prindëror, të braktisur, keqtrajtuar dhe të lënë pasdore.

Organizatë OFAP është e licencuar me staf të licencuar për ofrim të shërbimeve sociale dhe si e tillë ka përvojë shumëvjeçare në ofrimin e shërbimeve psiko-sociale, që i ka mundësuar

të zhvillojë burime njerëzore dhe logjistike për të bërë punë profesionale në fushën e vet. Organizata veprimtarin e saj e ushtron në tërë vendin, të cilin e arrin përmes partnerëve nacional dhe lokalë me implementim të aktiviteteve të përbashkëta. Në këtë bashkëpunim ka ndikuar edhe imazhi që OFAP ka ndërtuar në publik, si dhe tek institucionet qeverisëse. Organizata mund të përdorë profesionalizmin e personelit të vet që ka dhe të vazhdojë të mbetet ofrues i pazëvendësueshëm i shërbimeve për fëmijët pa kujdes prindëror, të braktisur, keqtrajtuar dhe të lënë pasdore. Po ashtu, mund të rrisë numrin e shërbimeve si dhe numrin e përfituesve në shërbimet që ofron si dhe mund të bëjë planifikim më të mirë duke u bazuar drejtpërdrejt në nevojat e fëmijëve. Organizata ka kapacitete të mjaftueshme të ofrojë kontributin e saj në përmirësimin e politikave publike (të cilën e ka bërë dhe është duke e bërë në vazhdimësi) që prekin të drejtat e fëmijëve si dhe të avokojë për përmirësimin e gjendjes së tyre, me fokus fëmijët e braktisur, keqtrajtuar dhe të lënë pasdore.

4. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Synimi kryesor i Organizatës OFAP është, zbatimi në tërësi i dokumentit strategjik, proces ky që do të përcaktohet nga realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit. Procesi i zbatimit të masave të parashikuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit kanë një shtrirje prej 3 viteve, që përfshin vitet 2019-2021. Ndërsa, për zbatimin e objektivave strategjike, hartohet plani i veprimit 3 vjeçarë në të cilat përcaktohen objektivat e përgjithshme, objektivat specifike, aktivitete konkrete, gjendja ekzistuese, targeti, burimet financiare si dhe afatet kohore për realizimin e tyre. Monitorimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesor e procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimitet e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet.

Monitorimi do të jetë proces kyç për ofrimin e informatave të nevojshme, ai nuk do të jetë efektiv nëse nuk ndërmerren veprime ndaj asaj që është vlerësuar dhe raportuar. Prandaj, çdo fund vit stafi i Organizatës OFAP në bashkëpunim me mekanizmat përgjegjës të përcaktuar, do të hartojë raportin vjetorë i cili duhet të përmbajë vlerësimin e aktiviteteve më të

suksesshme dhe në përgjithësi përmbushjen e qëllimeve të strategjisë, identifikimin e sfidave dhe vështirësive të hasura gjatë procesit të zbatimit si dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete për mënjanimin e pengesave të paraqitura përgjatë procesit të përmbushjes së objektivave specifike dhe atyre strategjike.

Duke monitoruar strategjinë, Organizata OFAP do të jetë në gjendje të krijojë një pasqyrë mbi gjendjen, se deri në ç'masë ndodhet strategjia drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara, nxjerrjes së mësimave, marrjes së masave korrigjuese, dhe, nëse është e mundur, proceseve rishqyrtuese të saj. Në këtë kuptim, strategjia do të jetë një dokument dinamik, që do t'i përshtatet ndryshimit të objektivave, rrethanave dhe përvojës së fituar.

5. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Përmbushja e këtyre objektivave të përgjithshme do të kontribuojë në arritjen e synimeve të përcaktuara sipas vizionit, misionit dhe qëllimit të Organizatës OFAP. Po ashtu, objektivat e përgjithshme janë në përputhje me Konventen Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, Ligjeve dhe Akteve nënligjore të aplikuara në Republikën e Kosovës.

Objektivi-1: TË DREJTAT E FËMIJËVE NË NEVOJË

Objektivi-2: SHËRBIMET PËR FËMIJËT PA KUJDES PRINDËROR

Objektivi-3: MBËSHTETJE PËR GRUPET E CENUESHME TË FËMIJËVE

Objektivi-4: KOMUNIKIMI DHE INFORMIMI I PUBLIKUT

Objektivi-5: NGRITJA E KAPACITETEVE TË ORGANIZATËS OFAP

Objektivi-6: RISHIKIMI I DOKUMENTEVE TË ORGANIZATËS OFAP ÇDO FUND VIT

	6. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË TË ORGANIZATËS OFAP (2019-2021)
Objektivat e përgjithshme	I. TË DREJTAT E FËMIJËVE NË NEVOJË
Objektivat strategjike	1. PËRMIRËSIMI I POLITIKAVE, INFRASTRUKTURËS LIGJORE DHE KOORDINIMIT NË MBËSHTETJE TË FËMIJËVE NË NEVOJË
Indikatorë	1.1 Numri i politikave të draftuara ose rishikuara për të siguruar një menaxhim më të mirë me rastet e fëmijëve në nevojë.
Veprimet	1.1.1 Ligji i Familjes.
	1.1.2 Ligji për të Drejtat e Fëmijëve.
Indikatorë	1.2 Numri i ligjeve të draftuara ose rishikuara për të siguruar një menaxhim më të mirë me rastet e fëmijëve në nevojë.
Veprimet	1.2.1 Hartimi i Projekt Kodit Civil (Kapitulli i Fëmijëve pa Kujdes Prindëror).
	1.2.2 Amandamenti i Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.
	1.2.3 Amandamenti i Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal - Grandi Specifik.
Indikatorë	1.3 Numri i akteve nënligjore të draftuara ose rishikuara për të siguruar një menaxhim më të mirë me rastet e fëmijëve në nevojë.
Veprimet	1.3.1 Plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ për Strehim Familjar.
Indikatorë	1.4 Numri i procedurave të draftuara ose rishikuara për të siguruar një menaxhim më të mirë me rastet e fëmijëve në nevojë.
Veprimet	1.4.1 Standardet Minimale (14, 15, 15a).
	1.4.2 Projektet e Strehimit Familjar (Planet Individuale të Fëmijëve).
Indikatorë	1.5 Numri i takimeve koordinuese me akteret për të siguruar një koordinim më të mirë që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë.
Veprimet	1.5.1 Takime të rregullta me Nivelin Qendror (MPMS, MASHT, MPB, MSH).
	1.5.2 Takime të rregullta me Nivelin Lokal (DSHMS, DKA, QPS, ZKK, Enti për Punësim, Shkolla, Policia në Komunitet, OJQ, etj).
Objektivat e përgjithshme	II. SHËRBIMET PËR FËMIJËT PA KUJDES PRINDËROR
Objektivat strategjike	2. PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE PËR FËMIJËT PA KUJDES PRINDËROR
Indikatorë	2.1 Numri i fëmijëve që marrin shërbimin e strehimit familjar.
Veprimet	2.1.1 Sipas gjinisë.
	2.1.2 Sipas moshës.
	2.1.3 Sipas Etnisë.
	2.1.4 Sipas shkikut.
	2.1.5 Me aftësi të kufizuara.
Indikatorë	2.2 Numri i familjeve të trajnuara për dhënie të shërbimeve për kategori specifike të fëmijëve pa kujdes prindëror.
Veprimet	2.2.1 Fëmijët sipas grup-moshave.
	2.2.2 Fëmijët me aftësi të kufizuara.

	2.2.3 Fëmijët mbi moshën 18 vjeç.
	2.2.4 Fëmijët e braktisur.
	2.2.5 Fëmijët e keqtrajtuar.
Indikatorë	2.3 Numri i vizitave mbështetëse tek familjet strehuese.
Veprimet	2.3.1 Vizita të rregullta.
	2.3.2 Vizita të jashtëzakonshme.
Indikatorë	2.4 Numri i aktiviteteve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të stafit OFAP dhe aktereve për të punuar me fëmijët pa kujdes prindëror.
Veprimet	2.4.1 Ngritja e kapaciteteve të familjeve strehuese dhe të stafit OFAP.
	2.4.2 Përfshirja e target-grupeve të Organizatës OFAP.
	2.4.3 Profilizimi i familjeve strehuese.
	2.4.4 PDEP tek Familjet Strehuese dhe Stafi OFAP.
Indikatorë	2.5 Ngritja e efikasitetit në menaxhimin e rasteve.
Veprimet	2.5.1 Planet Individuale.
	2.5.2 Raportet psiko-sociale.
Objektivat e përgjithshme	III. MBËSHTETJE PËR GRUPET E CENUESHME TË FËMIJËVE
Objektivat strategjike	3. GRUPET E CENUESHME TË FËMIJËVE QË MARRIN MBËSHTETJEN E DUHUR
Indikatorë	3.1 Numri i fëmijëve të riatdhesuar që marrin shërbime psiko-sociale.
Veprimet	3.1.1 Mbështetje psiko-sociale për fëmijët dhe familjet e riatdhesuara.
	3.1.2 Trajnimi i familjeve të riatdhesuara për riintegrim më të lehtë.
Indikatorë	3.2 Numri i fëmijëve në nevojë që marrin shërbime profesionale.
Veprimet	3.2.1 Mbështetje psiko-sociale për fëmijët në SHFMU.
	3.2.2 Fëmijët e Prindërve përfitues të PDEP.
Indikatorë	3.3 Numri i kategorive të fëmijëve që përfitojnë shërbime psikologjike në QPS.
Veprimet	3.3.1 Fëmijë me sjellje asociale.
	3.3.2 Fëmijë delikuent.
	3.3.3 Besimi i fëmijëve në raste të divorcuara.
	3.3.4 Fëmijë me çrregullime psikologjike.
	3.3.5 Fëmijë të ekspozuar ndaj abuzimit.
Objektivat e përgjithshme	IV. KOMUNIKIMI DHE INFORMIMI I PUBLIKUT
Objektivat strategjike	4. PËRMIRËSIMI I QASJES NË INFORMACION MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE NË NEVOJË
Indikatorë	4.1 Numri i fushatave për të drejtat e fëmijëve në nevojë.
Veprimet	4.1.1 Informim në media elektronike dhe të shkruara.
	4.1.2 Artikuj në rrjetet sociale.
	4.1.3 Kampanja vetëdijësuese.
Indikatorë	4.2 Numri i produkteve informuese, vetëdijësuese, për të drejtat e fëmijëve në nevojë.
Veprimet	4.2.1 Dokumentare - Videoklipe.
	4.2.2 Broshura.

	4.3.3 Postera.
	4.3.4 Fllajera.
	4.3.5 Billborde.
Indikatorë	4.3 Numri i aktiviteteve informuese, vetëdijësuese për të drejtat e fëmijëve në nevojë.
Veprimet	4.3.1 Takime me komunitetin.
	4.3.2 Takime me Profesionist të fushave të ndryshme.
Indikatorë	4.4 Numri i fëmijëve të informuar mbi të drejtat e tyre.
Veprimet	4.4.1 Fëmijët në Strehim Familjar.
	4.4.2 Fëmijët në Shkolla.
	4.4.3 Kategoritë e ndryshme të Fëmijëve në QPS dhe ZKK.
Objektivat e përgjithshme	V. NGRITJA E KAPACITETEVE TË ORGANIZATËS OFAP
Objektivat strategjike	5. NEVOJAT E NGRITJES SË KAPACITETEVE TË ORGANIZATËS OFAP
Indikatorë	5.1 Numri i dokumenteve të hartuara.
Veprimet	5.1.1 Manualët financiarë dhe të prokurimit.
	5.1.2 Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit.
	5.1.3 Strategjia dhe Plani i Veprimit të Organizatës OFAP (2019-2021).
	5.1.4 Rregullore për Barazi Gjinore.
	5.1.5 Strategjia për avokim.
	5.1.6 Politikat e mbrojtjes së fëmijëve.
	5.1.7 Manual për resurse humane.
Indikatorë	5.2 Numri i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të Stafit OFAP.
Veprimet	5.2.1 Trajnim për Monitorim dhe Vlerësim.
	5.2.2 Trajnim për Barazi Gjinore.
	5.2.3 Trajnim për prokurim.
	5.2.4 Trajnim për QUIK BOOK.
	5.2.5 Trajnim për Menagjim dhe Lidership.
	5.2.6 Trajnim për Avokim dhe Lobim.
	5.2.7 Trajnim për Komunikim me Media.
Indikatorë	5.3 Numri i aktiviteteve për rritjen e fondeve.
Veprimet	5.3.1 Takime vjetore me Partner dhe Donatorë.
	5.3.2 Takime me kompani të ndryshme.
Objektivat e përgjithshme	VI. RISHIKIMI I DOKUMENTEVE TË ORGANIZATËS OFAP ÇDO FUND VIT
Objektivat strategjike	6. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I BRENDSHËM I ORGANIZATËS OFAP
Indikatorë	6.1 Numri i dokumenteve vlerësuese të Organizatës OFAP.
Veprimet	6.1.1 Strategjia dhe Plani i Veprimit.
	6.1.2 Identiteti organizativ.
	6.1.3 Menaxhimi i stafit.
	6.1.4 Sistemet e burimeve njerëzore dhe politikat e personelit.

	6.1.5 Kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm.
	6.1.6 Prokurimi.
	6.1.7 Planifikimi dhe Buxheti.
	6.1.8 Raportimi Financiar.
	6.1.9 Stafi dhe Bordi.
	6.1.10 Donatorët dhe menaxhimi i granteve.
	6.1.11 Qëndrueshmëria financiare dhe mbledhja e fondeve.
	6.1.12 Menaxhimi i Projekteve.
	6.1.13 Rëndësia dhe shtrirja.
	6.1.14 Planifikimi, Zbatimi dhe Raportimi.
	6.1.15 Monitorimi, Vlerësimi dhe Mësimi.
	6.1.16 Stabiliteti.
	6.1.17 Angazhimi i Komunitetit.
	6.1.18 Shprehja e përshtypjeve/reagimeve.
	6.1.19 Rrjetëzimi.
	6.1.20 Marrëdhëniet me palët e interesuara.
	6.1.21 Avokimi.
	6.1.22 Marrëdhëniet e anëtarëve.